

UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”
FAKULTETI EKONOMIK



Albulena Shala

**EFEKTET E NJËTRAJTËSIMIT TË TË ARDHURAVE
NË KREDIDHËNIEN NGA ANA E SEKTORIT
BANKAR NË KOSOVË**

PUNIM I DOKTORATËS

Prishtinë, 2017

UNIVERSITY OF PRISHTINA "HASAN PRISHTINA"
FACULTY OF ECONOMICS



Albulena Shala

**EFFECTS OF INCOME SMOOTHING ON LENDING
OF THE BANKING SECTOR IN KOSOVA**

DOCTORAL THESIS

Prishtinë, 2017

Abstrakti

Kjo tezë ofron dëshmi empirike mbi njëtrajtësimin e të ardhurave nga ana e sektorit bankar në vendet e Evropës Juglindore (EJL) dhe ndikimin e njëtrajtësimin të të ardhurave në kredidhënien nga ana e sektorit bankar. Teza përfshinë të dhëna për bankat nga nëntë vende të EJL-re për periudhën 2005-2014, duke përdorur një sërë qasjesh metodologjike. Objektivi i parë i tezës është evidentimi i përdorimit të provizioneve për humbje të kredive (LLP) për njëtrajtësimin e të ardhurave nga ana e sektorit bankar. Duke përdorur modelet e regresionit linear vlerësimet evidentojnë për një koeficient pozitiv të variablës së fitimit para taksave dhe provizioneve (EBTP), që konfirmon se bankat kanë përdorur LLP-në për të njëtrajtësuar të ardhurat e tyre. Ky rezultat tregon se bankat i kanë rritur më shumë LLP-të kur kanë patur fitime të larta, si dhe kanë krijuar me pak provizione kur fitimet e tyre kane qenë të ulëta. Vlerësimi për Kosovën tregoi se sjellja e bankave ishte e ngjashme me rezultatet e bankave të EJL-re. Së dyti, duke e ndarë LLP-në në dy komponentët e saj (diskret dhe jo diskret) teza siguron prova të reja mbi ndikimin e dy komponentëve të LLP-së në kredidhënien e sektorit bankar. Ne kemi gjetur se provizionet diskrete dhe jo diskrete kanë ndikim negativ në kredidhënien e sektorit bankar në EJL-re.

Objektiva e tretë e tezës është vlerësimi i ndikimit të kushteve makroekonomike në LLP-në dhe përdorimi i LLP-së për menaxhimin e kapitalit. Provizionimi duket të varet ndjeshëm nga cikli i biznesit, siç dëshmohet nga lidhja e drejtpërdrejtë negative midis variablës së rritjes të GDP-së dhe LLP-së. Ky efekt i fortë ciklik nënkupton që sjellja e bankave mund të jetë prociklike që do të thotë nëse rezervat për LLP-në do të rriten më shumë gjatë periudhës së rënies ekonomike, kjo do të sjell një nivel më të ulët fitimi për të plotësuar kapitalin, duke bërë që bankat të reduktojnë nivelin e dhënies së kredisë. Ndërsa sa i përket përdorimit të LLP-ve për menaxhimin e kapitalit rezultatet empirike nuk mbështesin hipotezën e menaxhimit të kapitalit për bankat e EJL-re, kjo është evidentuar përmes lidhjes pozitive por jo signifikante në mes të LLP-së dhe normës së mjaftueshmërisë së kapitalit (CAP). Ky rezultat tregon se bankat nuk e kanë përdorur LLP-në si mjet për të përmbushur kriteret e kapitalit të vendosura nga autoriteti monetar. Një shpjegim i këtij rezultati ka të bëjë me faktin që bankat në EJL-re kanë patur nivele të konsiderueshme të kapitalit i cili ka shërbyer si mburojë edhe gjatë goditjeve të marra nga kriza e fundit financiare.

Fjalët kyçe: provizioni për humbje të kredive, manipulimet në kontabilitet, njëtrajtësimi i të ardhurave, menaxhimi i kapitalit.

Abstract

This thesis provides empirical evidence on income smoothing from the banking sector in SEE countries and the impact of income smoothing on lending by the banking sector. The thesis includes the data on banks from nine SEE countries for the period 2005-2014, using a number of methodological approaches. The first objective of the thesis is to identify the use of Loan Loss Provisions (LLP) for income smoothing by the banking sector. Using linear regression models, estimates show a positive coefficient of variable of earnings before tax and provisions (EBTP), which confirms that banks have used LLP to smooth their income. This result shows that banks have increased the level of LLPs when they have had high profits and have showed lower provisions when their profits have been low. The estimation for Kosovo showed that banks' behavior was similar to the results of SEE banks. Secondly, by dividing the LLP into its two components (discretionary and non-discretionary), the thesis provides new evidence on the impact of two LLP components on the banking sector lending. We have found that discretionary and non-discretionary provisions have a negative impact on the lending activity of the SEE banking sector. The third objective of the thesis is to estimate the impact of the macroeconomic conditions on LLP and the use of LLP for the capital management. Loan Loss Provisions seem to depend heavily on the business cycle, as evidenced by the direct negative correlation between the variable of GDP growth and LLP. This strong cyclical effect implies that bank behavior can be pro-cyclical, meaning that LLP reserves will grow more during the economic downturn period, this will bring a lower level of profit to supplement capital, causing the banks to reduce the level of lending. As for the use of LLPs for capital management, the empirical results do not support the hypothesis of capital adequacy for SEE banks, this is evidenced by the positive but not significant relationship between LLP and the capital adequacy ratio (CAP). This result shows that banks have not used LLP as a tool to meet the capital criteria set by the monetary authority. An explanation of this result is that banks in SEE had significant levels of capital which served as a shield even during the shocks of the recent financial crisis.

Keywords: provision for credit losses, accounting manipulation, income smoothing, capital management.